



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 1537 Prot.

Patos më, 12/06/2024



MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 48, datë 12.06.2024

MBI MIRATIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIM MURI MBAJTËS ME STRUKTURA METALIKE PËR PËRFORCIM BAZAMENTI DHE RIKONSTRUKSION I RRUGËS SË DËMTUAR NGA RRËSHQITJA E DHERAVE” ME VLERË 39,730,565 LEKË

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 307, datë 22.05.2024 “Për miratimin e projekteve fitueses të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet ti nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, VKB nr. 81, datë 18.12.2023 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe buxhetin për vitin 2024”, thirrjes për aplikim nga Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile nr. 2179/3 prot., datë 29.12.2023, aplikimit për financim nëpërmjet shkresës nr. 292 prot., datë 31.01.2024. Ekipi i programit të menaxhimit për të vazhduar me procedurat e mëtejshme të implementimit të projektit,

KËRKON:

1. Miratimin e projektit “Ndërtim muri mbajtës me struktura metalike për përforcim bazamenti dhe rikonstruksion i rrugës së dëmtuar nga rrëshqitja e dherave”, me vlerë 39,730,565 (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë të financuar nga AKMC.
2. Miratimin e vlerës prej 592,000 (pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë (ku përfshin vlerën oponencë, mbikqyrje dhe kolaudim të projektit) të cilat do të mbulohen nga buxheti vendor me transfertë brenda programit nga fondet e çliruara.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Ermenita MICI
Marsilda LIZAJ

Gazmira PLESATI
Arlind RUSTO

Silvana MICI
Nurkë HAZIZAJ



REPUBLIKA ESHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Nr. 1537 Prot.

Patos më, 12.06 /2024

RELACION PËR PROJEKT-VENDIM

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIM MURI MBAJTËS ME STRUKTURA METALIKE PËR PËRFORCIM BAZAMENTI DHE RIKONSTRUKSION I RRUGËS SË DËMTUAR NGA RRËSHQITJA E DHERAVE” ME VLERË 39,730,565 LEKË

Bashkia Patos, në thirrjen e hapur për aplikime në programin “Fonde për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore”, ka aplikuar nëpërmjet projektit “Ndërtim muri mbajtës me struktura metalike për përforcim bazamenti dhe rikonstruksion i rrugës së dëmtuar nga rrëshqitja e dherave” me vendodhje në lagjen “1 Maj”, rruga “Demokracia”, i vlerësuar nga grupi i projektimit pranë drejtorisë planifikimit dhe zhvillimit territorit si një ndër projektet, i cili kërkon ndërhyrje të menjëhershme për parandalimin e pasojave që mund të sjellë një rrëshqitje e mundshme dherave në zonë. Me vendimin nr. 307, datë 22.05.2024, është miratuar lista e projekteve të financuara për vitin 2024, pjesë e së cilës është edhe projekti i aplikuar.

Projekti parashikon ndërtimin e një muri mbajtës me strukturë metalike (tip palankola) me gjatësi 65ml dhe sistemimin e sipërfaqes së rrugës përgjatë gjatësisë së murit.

Zona në të cilën kërkohet të ndërhyhet është mjaft e vështirë pasi kemi të bëjme me një disnivel të konsiderueshëm të terrenit midis kahut të majtë dhe të djathtë të rrugës “Demokracia”, ku në 2 nivelet kemi dy objekte pallate 5-katësh. Rruga ka gjurmë shkarjeje, ç’ka përbën paralajmërim për fillimin e krijimit të një zone më të madhe rrëshqitjeje, e cila do të rezultonte tepër e rrezikshme për objektet e banimit në afërsi.

Qëllimi i projektit të hartuar është stabilizimi dhe përforcimi i masivit të dherave, nëpërmjet implementimit të palankolave metalike, të cilat do të garantojnë qëndrueshmërinë e terrenit dhe bazamentit të rrugës.

Efektet e pritshme nga zbatimi i projektit janë parandalimi i rrezikut i shkarjes së dherave dhe krijimi i një infrastrukture të qëndrueshme sipas standarteve për banorët e zonës.

Vlera e projektit është 39,730,565 (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë dhe financimi do të mbulohej nga Agjencia kombëtare e mbrojtjes civile.

Kostot për oponencën e projektit, mbikqyrjen dhe kolaudim e punimeve, janë në vlerën 592,000 lekë dhe do të përballohen nga buxheti vendor.

Nisur nga sa më sipër, kërkohet nga Këshilli i Bashkisë:

1. Miratimin e projektit “Ndërtim muri mbajtës me struktura metalike për përforcim bazamenti dhe rikonstruksion i rrugës së dëmtuar nga rrëshqitja e dherave”, me vlerë 39,730,565 lekë të financuar nga AKMC.
1. Miratimin e vlerës prej 592,000 lekë (ku përfshihet vlera për oponencën e projektit, mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve), të cilat do të mbulohen nga buxheti vendor me transfertë brenda programit nga fondet e çliruara.
2. Për ndjekjen e zbatimin e projekt-vendimit ngarkohet drejtoria e financës, sektori i prokurimeve dhe drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Ermenita **MICI**



Gazmira **PLESATI**



Silvana **MICI**



Marsilda **LIZAJ**



Arlind **RUSTO**



KRYETARI
Fation Duro

